



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER ALKET Z. MANÇKA
ADRESA NR.2, ASIM ZENELI, NR.10,
NR.6
TEL: 693645101**

PËRPILIM DHE VËRTETIM TË SH.P.K.-VE

(AKT THEMELIMI DHE STATUT)

Nr. repertori: 6286

Nr. koleksioni: 3881

Tirane më 17/10/2022

Ligjet referuese:

1. Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
2. Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënavce personale", i ndryshuar
3. Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2022051400428392309



A10110514004289119

Sot, më datë 17/10/2022, para meje Noter ALKET Z. MANÇKA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.2, ASIM ZENELI, NR.10, NR.6, u paraqit personalisht:

AKT THEMELIMI DHE STATUT

I

HOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“AMOR BISTRO BAR”

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Ligjet Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit”, i ndryshuar”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

KREU I THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1: Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- (1) Sot, më (17/10/2022), me cilësinë e ortakëve kemi redaktuar këtë akt themelimi dhe statut, për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në respektim te Kodit Civil, Ligjet Nr. 9901, date 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe Ligjet Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit”, i ndryshuar.
- (2) Ne themeluesit, kemi themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përpunje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë me emërtimin **AMOR BISTRO BAR SH.P.K.**:

- **“LANDWAYS INTERNATIONAL”SH.P.K**, me NUIS K61422004L, me seli qendrore në adresën: Rr. “Themistokli Gërmenji”, Hyrja 1, Kat 1, (pranë RTSH) Tirana dhe Administrator z. Gazmend Haxhia;
- **“ARC”** me NUIS K81728025F, me seli qendrore ne adresën: Rr. “Themistokli Gërmenji”, Nd. 1, Tirana dhe Administrator z. Zenel Hysenbegasi;
- **Z. Admir Bezhani**, i biri i Kostes, shtetas shqiptar, i datëlindjes 17.01.1976, lindur dhe banues në Tirane, madhor, me zotësi të plote juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ID me nr. 036165342 dhe numër personal H60117037R.

Neni 2: Objekti

- (1) Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në:
Restoran, bar, shitje me pakicë, take away ose delivery.



A2011051400428892339

- (2) Në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të aktivitetit të saj.

**Neni 3:
Kohëzgjatja**

- (1) Shoqëria krijohet për një afat kohor **prej 10 vitesh**. Me vendim të Asamblesë së Ortakëve kohëzgjatja e shoqërisë mund të shkurtohet apo zgjatet.

**Neni 4:
Selia**

- (1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Tirana International Airport “Nënë Tereza”, Food & Beverage Area No. _ Landside, Rinas, Kruje.**
(2) Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është **amarbistrobar.al**
(3) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon **contact@amarbistrobar.al**

**KREU II
KAPITALI**

**Neni 5
Kapitali themeltar**

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000.00 ALL (njëqind mijë lekë). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
1. Ortaku themelues Landways International: zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 35,000.00 ALL, që përbën 35% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 2. Ortaku themelues ARC: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 35,000.00 ALL që përbën 35% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 3. Ortaku themelues Admir Bezhani: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 30,000.00 ALL që përbën 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- (2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**Neni 6:
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

- (1) Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- (2) Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- (3) Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- (4) Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.



A1021051400418391309



Neni 7

Transferimi i kapitalit

- (1) Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- (2) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- (3) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimmarrës

- (1) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- (2) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë qe miraton çdo ndryshim të statutit sipas modalitetave të përcaktuara në ligj.
- (3) Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- (4) Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- (5) Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- (6) Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.



A1011051400418892359

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

- (1) Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkressë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrë datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- (2) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

- (1) Në rastin e marjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- (2) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- (3) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

- (1) Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruarve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për:
 - a) ndryshimin e statutit;
 - b) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
 - c) shpërndarjen e fitimeve;
 - ç) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- (2) Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si:
 - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve;
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - g) nënshkrimin e kontratave, transaksioneve bankare dhe dokumentave me natyrë financiare mbi vlerën 30,000.00 (tridhjetë mijë) Euro.
- (3) Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.



A1001051400428392109

**Neni 12
Përjashtimi nga e drejta e votës**

(1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

(2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

**Neni 13
Administrimi**

- (1) Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga Administratori i Vetëm.
- (2) Administratori emërohet me vendim të Ortakëve dhe qëndron në këtë detyrë për një afat jo më të gjatë se 5 (pesë) vjet. Administratori mund të rizgjidhet për të njëjtën periudhë me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.
- (3) Administrator i Shoqërisë do të jetë:

Z. Admir Bezhani, i biri i Kostes, shtetas shqiptar, datëlindjes 17.01.1976, lindur dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plote juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ID me nr. 036165342 dhe numër personal H60117037R

me specimen nënshkrimi:

- (4) Administratori mund të shkarkohet me vendim të ortakëve në çdo moment.
- (5) Administratori është personalisht përgjegjës përpara Shoqërisë dhe/ose palëve të treta për dëme të shkaktuara nga shkelja e dispozitave të këtij Statuti ose të Ligjit.

**Neni 14
Kompetencat e Administratorëve**

- (1) Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç. përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme përmiratim;
 - d. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;



A1011051400428891309

- e. raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

- (2) *Kufizimet e kompetencave te administratorit:* Administratori mund te nënshkruajë kontrata, transaksione bankare dhe dokumenta me natyre financiare me vlerë deri në shumën prej 30,000.00 (tridhjetë mijë) Euro. Për kontrata, transaksione bankare dhe dokumenta me natyrë financiare mbi vlerën 30,000.00 (tridhjetë mijë) Euro, z. Admir Bezhani nënshkruan bashkërisht me administratorin e ortakut "LANDWAYS INTERNATIONAL" sh.p.k, z. Gazmand Haxhia ose nënshkruan vetëm z. Admir Bezhani, në bazë të autorizimit paraprak të dhënë me anë të Vendimit të Ortakëve të Shoqërisë.
- (3) Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asambleën e Përgjithshme, në rastet kur:
 - sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- (4) Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- (5) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbllimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, irregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 Përgjegjësitë e Administratorit

- (1) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- (2) Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- (3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- (4) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryen në mirëbesim.



A1011051400428392309

- (5) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- (6) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - c) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - d) jep kredi.
- (7) Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrënë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 16

Viti Financiar

- (1) Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

- (1) Eksperti ka për detyre që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimitarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- (2) Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ja paraqesë e dorëzoje në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

- (1) Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë:



A1011051400428391309

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtar për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
 - d) me vendim të gjykatës;
- (2) Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri ne likuidim e sipër".
- (3) Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur ështënisur një procedurë falimentimi.
- (4) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
- (5) Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19 Riorganizim i shoqërisë bashkimi-ndarja

- (1) Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX, të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

- (1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.
- (2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

- (1) Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptar.

O R T A K E T

E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"AMOR BISTRO BAR SH.P.K"

"LANDWAYS INTERNATIONAL" SHPK

General Manager
landways
INTERNATIONAL
DESTINATION MANAGEMENT COMPANY
NUIIS: K6142204L

"ARC" SHPK

Kamil Shabani
NIPT: K81001323
TRADE - ALBANIA

ADMIR BEZHANI

Admir Bezhani